

VENDIM
Nr. 297, datë 23.5.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, GJYKATËN E LARTË, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 1/2 dhe në lidhjen 5/4, që përmendet në pikën 8/4, emërtesa “Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit”, zëvendësohet me emërtesën “Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore”.

b) Në pikën 1/3/a shtohen emërtesat “Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë”, “Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit” dhe “Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë”.

c) Në lidhjen 2/1, që përmendet në pikën 2/c, emërtesa “Kryendihmës në kabinetin e Kryeministrit”, zëvendësohet me emërtesën “Analist në kabinetin e Kryeministrit”.

ç) Në lidhjen 3, që përmendet në pikën 3, të shtohet sa vijon:

Komisioni i Prokurimit Publik	Inspektor	III-a
-------------------------------	-----------	-------

d) Pas pikës 9/11 shtohen pikat 9/12 e 9/13, me këtë përmbajtje:

“9/12. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar i institucionit” në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në nivel qendror, janë sipas lidhjes nr. 6/12, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/13. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar i institucionit” në Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, janë sipas lidhjes nr. 6/13, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

dh) Në lidhjen nr. 9, që përmendet në pikën 12:

i) shfuqizohen emërtesat:

- Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë – kategoria III-b;
- Përgjegjës sektori në drejtoritë e bujqësisë – kategoria IV-a;
- Specialist në drejtoritë e bujqësisë – kategoria IV-b;

ii) shtohen emërtesat:

- Drejtor i agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor – kategoria III-b;
- Drejtor i agjencive rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve – kategoria III-b;
- Përgjegjës sektori në agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor – kategoria IV-a;
- Përgjegjës sektori në agjencitë rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve – kategoria IV-a;
- Specialist në agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor – kategoria IV-b;
- Specialist në agjencitë rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve – kategoria IV-b.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2018, të fillojnë nga momenti i emërimit apo transferimit të nëpunësve/punonjësve në pozicionet e reja të punës dhe të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për vitin 2018.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Lidhja nr. 6/12

Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në nivel qendror

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT	SHTESA PËR KUSHTE PUNE
Titullar i institucionit	II-a	1	10.000
Drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes	II-b	1	10.000
Drejtor drejtorie në drejtoritë mbështetëse	II-b	1	0
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes	III-a	1	10.000
Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës	III-a/1	1	0
Specialist në sektorët dhe drejtoritë e përmbajtjes	III-b	1 ose 2	10.000
Specialist në sektorët dhe drejtoritë e përmbajtjes	IV-a	1 ose 2, ose 3	10.000
Specialist në sektorët mbështetës	IV-a	1 ose 2, ose 3	0
	IV-b	1 ose 2, ose 3	0

Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe donatorëve të tjerë

POZICIONI	KATEGORI A	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT	SHTESA PËR KUSHTE PUNE
Titullar i institucionit	II-a	1	10.000
Zëvendësdrejtör i Përgjithshëm. Drejtör drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes	II-b	1	10.000
Drejtör drejtorie në drejtoritë mbështetëse	II-b	1	0
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes	III-a	1	10.000
Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës	III-a/1	1	0
Specialist në sektorët dhe drejtoritë e përmbajtjes	III-b	1 ose 2	10.000
Specialist në sektorët dhe drejtoritë e përmbajtjes	IV-a	1 ose 2, ose 3	10.000
Specialist në sektorët mbështetës	IV-a	1 ose 2, ose 3	0
	IV-b	1 ose 2, ose 3	0